



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 126, Datë 04.06.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND POWER ALBANIA” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika, gërma “d” dhe 13 të “Rregullores për Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 21 Prot, datë 05.04.2018, shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për Furnizimin e Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 91, datë 20.04.2018, vendosi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të vendimit të fillimit të procedurës me shkresën nr. 55/28 Prot., datë 07.05.2018 është bërë njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe pika 4.7.1, gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Wind Power Albania” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI